



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 58

Datë: 09. 09. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvic,
Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 54 dhe 55/2021.**
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

- Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit të anëtarit të KKZ-së në komunën e Glllogocit.
- Raportit njoftues nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë,
- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së Fletëvotimit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së VPNV-së.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për zgjedhjet lokale 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotim
- Njoftim me Udhëzuesin për Trajnimin e trajnerëve të Këshillave të vendvotimit.

6. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

- Njoftim nga Këshilli për informim publik

7. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi : Para se me filluar mbledhja, deshta me shprehë një ngushëllim për familjarët, fillimisht

për personat për incidentin e mbrëmshëm që ka ndodhë dhe që kanë qenë anëtarë të PDK-së, ngushëllime familjes, si dhe për tragjedinë që ndodhi në Tetovë. Ngushëllimet i shprehi në emër të anëtarëve të KQZ-së dhe Sekretariatit. Vazhdojmë me mbledhjen e 58-të, mungon vetëm anëtari Florian Dushi i cili, nuk mund të marrë pjesë në këtë takim. Para vetes e keni rendin e ditës. A ka dikush diçka me shtue në lidhje me rendin e ditës ?

Arianit Elshani: Lidhur me pikën e pestë, “Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për zgjedhjet lokale 2021”, sipas Sekretariatit nuk është gati dizajni i doracakut dhe, rekomandojmë që të hiqet nga rendi i ditës.

Kreshnik Radoniqi : Atëherë a ka dikush diçka tjetër lidhur me këtë rend të ditës, do të thotë me këtë ndryshim, e hedh në votim kush është për këtë rend të ditës ?

Me 10 vota për, votohet rendi i ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, miratohen me vota unanime procesverbalet nr. 54 ,55 dhe 56/ 2021.

Alim Rama: (nuk dëgjohej)

Kreshnik Radoniqi: E lexova edhe në procesverbalin e fundit, edhe prapë po i them të njëjtat fjalë: ne, nuk e kemi procesverbalin e Komitetit të Auditimit ! Këtë e kam kërkuar, me e pas procesverbalin se çka kanë ndërmarrë, çka kanë diskutuar anëtarët e Komitetit të Auditimit...Jemi pajtuar se pasi që ta marrim atë procesverbal, dhe si e kanë votuar ata këtë çështje, atëherë do të veprojmë. Nuk kam thënë që do ta dërgojmë në prokurori këtë, shikojeni të gjithë procesverbalet, kam thënë do ta trajtojmë...Nuk po them që nuk ka me shkuar, atë çështje mundet me bërë çdokush, mundet me paraqitë në prokurori apo në polici kallëzim penal...Askujt nuk i ndalohet, nëse mendoni që duhet domosdoshmërisht unë më bërë e marrim një vendim...Për çdo mbledhje është duke u ngritur kjo çështje, nuk jemi duke e anashkuar, nuk jemi duke mos dashtë me e dërguar, jemi tu dashtë me pa çfarë ka diskutua komiteti...Unë, me sa e dëgjova z. Selmanaj në mbledhjen e kaluar tha se “nuk kemi marrë ndonjë veprim për me i dërguar ato në prokurori...”. Tash, mbetet ta shohim procesverbalin po unë kisha kaluar në aktivitetet e Sekretariatit, ndërsa komiteti mundet me mbajte mbledhje të jashtëzakonshme lidhur me këtë dhe mos me e stërgjatë në një mbledhje të KQZ-së se i kemi disa pika tjera...

Sami Kurteshi: Sa i përket procesverbaleve të Komitetit të Auditimit, unë edhe herën e kaluar, dy herë kam kërkuar që procesverbalet të përgatitjen, e sa i përket vendimit të Komitetit të Auditimit, komiteti i auditimit i shqyrton të gjitha të dhënat dhe konstaton në atë kuptim vendime komiteti nuk merr, i shqyrton, është gjendje e mirë, gjysmë e mirë, është gjendje shumë e keqe..., mirëpo vendime nuk merr por edhe ideja që me e thirre Komitetin e Auditimit vetëm për këtë çështje, me e detyruar me marrë një vendim, ajo mund të bëhet por mirë është me i sjellë procesverbalet e Komitetit të Auditimit, me i pa se për çfarë është diskutuar...

Alim Rama: Ne, e kemi trajtuar atë raportin të auditorit...Raporti ka konstatuar shkelje, atëherë unë nuk mund të kuptoj pse ju si bartës i institucionit nuk e dorëzoni atë më tutje, nuk po e di në cilën mbledhje ka qenë, ne e kemi konstatuar të gjithë, jemi pajtuar që raporti i auditorit ka konstatuar që ka shkelje dhe hapi më tutje ka qenë të vazhdoni me organet e drejtësisë...Nëse ka nevojë, unë e propozoj për mbledhjen e radhës që na si KQZ, duam që ky raport të shkojë dhe ju si bartës i institucionit jeni të obliguar në emër të KQZ-së ta dërgoni...

Ilir Gashi: Po, mendoj që procesverbalet e këshillave nuk i trajtojmë këtu! Këshillat këtu sjellin rekomandime për temat të cilat janë me interes dhe që i trajton KQZ, jemi disa këshilla dhe me filluar ne tani me i trajtua procesverbalet se çka kanë folur nëpër këshilla anëtarët, është e pamundshme dhe e panevojshme të bëhet...E dyta, po më duket se jemi duke e trajtua këtë institucion ndaras, por çka do që ndodhë në emër të këtij institucioni, jemi ne dhe mendoj që duhet me e trajtua më ndryshe: kushdo që ka vërejtur ose sheh, ose konsideron që ka parregullsi ose diçka po ndodhë jashtë kompetencave, atëherë mundet me e ngritë ndonjë çështje dhe ndonjë kallëzim penal... Unë mendoj se si komision kemi të drejtë me i trajtua çështjet, pra këndo që ka vërejtje për parregullsi, e inkurajoj të veprojë edhe si i pavarur, madje edhe me ngritë kallëzim penal kështu që, mendoj se po e ngarkojmë këtë mbledhje vazhdimisht...

Ibrahim Selmanaj: Unë, nuk deshta me folë fare por, detyrohem sepse komiteti ka rekomanduar dhe sugjeruar që në fushat të cilat janë bërë shkelje, menaxhmenti të marrë masa dhe të mos përsëriten këto shkelje...Një prej sugjerimeve, dhe kryesorja është edhe auditori i brendshëm që, brenda KQZ-së duhet të bëjë rekomandime për trupat që janë brenda administratës së KQZ-së. Po mendoj se nuk është shpëtimtar i institucionit z. Rama me ngrit kauza si edhe herave tjera; dhe në zgjedhjet e kaluara i ka pasur disa kauza krejt tjera; tash e ka një element të dytë që krejt problemin që e kemi para vetes e bartë në pikën e parë, pra pasi që hapet rendi i ditës, pasi të miratohet dhe se kjo nuk bëhet krejt rastësisht por, me e zhvendos opinionin në tema që i kemi shumë të rëndësishme...

Čemailj Kurtiši: Ju kryetar se bashku me kryetarin e komitetit, me kryeshefin dhe me të tjerët përgatiteni dhe pastaj të shohim, sepse nuk ishte dashur që ne të humbim kohë...në secilen mbledhje..Nëse kjo përgatitet, e shohim se çfarë hapa duhet ndërmarrë dhe ne s' humbim kohë...Kështu, do të duhej të ishte edhe për çështjet e tjera...

Alim Rama: Nuk dua të polemizoj me kolegë por vetëm deshta, ky është fakt, ai raport ka konstatuar disa shkelje, ai është prezantuar në KQZ prej Komitetit të Auditimit...Raporti ka evidentuar disa shkelje të cilat janë konkrete; auditori i brendshëm e ka kryer punën e vet; tash krejt çfarë ka mbete, i ka mbete KQZ-së me e dërgua më tutje...

Arianit Elshan: Është e vërtetë se disa herë po diskutohet kjo temë dhe fatkeqësisht nuk e kemi rend ditës! Ne, e kemi pasur njëherë si informatë, si njoftim lidhur me raportin e Auditimit; ne si KQZ e kemi marrë një vendim ku kemi krijuar për herë të parë pas shumë viteve: kemi funksionalizuar Komitetin e Auditimit; unë mendoj se është komiteti i përbërë nga njerëz të fushës, të profesionit që e njohin këtë fushë dhe dy anëtarë të KQZ-së që e përfaqësojnë KQZ-në brenda atij komiteti...

Ne, tha z. Elshani, duhet ti shohim qartas edhe kompetencat që i ka aty Komiteti i Auditimit që i aprovon dhe miraton raportet, edhe e organizon punën e auditorit të brendshëm; është mirë nga Sekretariati sepse është kërkesë legjitime që të shikohet procesverbali; unë e kuptoj që ka volum të madh të punës nga mbledhjet e KQZ-së, nga mbledhjet e këshillave të KQZ-së mirëpo, të shikohet procesverbali lidhur me vendimin që është marrë në Komitetin e Auditimit dhe ato vendime që janë marrë aty, të zbatohen nga KQZ-ja, në këtë rast nga Sekretariati...Pastaj, ne e dimë që janë mundësitë edhe për çështjet e verifikimit, qoftë të procedohet tutje te Auditori i Përgjithshëm lidhur me vlerësimin ose në Ministri të Financave ashtu siç kemi vepruar edhe me raportet e tjera të auditimit...Është kjo mundësi për këdo që, mund të dyshojë se raporti nuk mund të jetë i drejtë apo është i drejtë mirëpo, ndoshta rekomandimet nuk janë të duhura kështu që ato rekomandime që janë dhënë brenda komunitetit të auditimit do të zbatohen, por e para, të zbardhet i gjithë ai transkript...

Sami Kurteshi: Dua ti sqaroj disa çështje: Ne, jemi institucion publik dhe duhet ta ketë secili parasysh këtë, ju pëlqen apo nuk ju pëlqen sepse, është hapë tema...Çdo temë me karakter publik ka me u hapë në publik, mbledhjet e KQZ-ja për këtë punë janë; ne kemi me hapë çdo çështje...E dyta, komiteti i Auditimit e ka shqyrtuar raportin e auditimit dhe ka konstatuar shkelje të jashtëzakonisht të rënda, ka konstatuar vjedhje; kjo ka me shkuar në prokurori; duhet te flasim qartë Komiteti i Auditimit nuk merre vendim por rekomandime; ju mund ta dëgjoni transkriptin, unë këtu se kam transkriptin...E treta, këtu ka hezitim...! E nëse ka hezitim, unë po ju tregoj si anëtar i Komitetit të Auditimit dhe si kryesues i Komunitetit të Auditimit se, nëse brenda kësaj jave nuk shkojnë raportet në prokurori, personalisht kam me i marrë unë dhe me i dërgue...Këtë kam të drejtë me e bërë personalisht, se nuk ka asnjë çështje publike që ka të bëjë me mjetet publike, që është publike në RKS që ka të bëjë me KQZ-në që ne nuk kemi të drejtë me e hapë në çdo mbledhje nëse ajo nuk është kryer...Dhe, sa të doni mundeni me zgjatë diskutimin: çdo çështje që është publike që i takon KQZ-së, ne kemi me hapë!

Ne, këto mbledhje nuk i organizojmë për diçka tjetër veç për këto çështje që janë publike, për asnjë çështje tjetër...Pra, kërkesa e z. Rama është diskutuar në dy mbledhje dhe po hezitohet me u veprua... Nëse nuk shkojnë raportet në prokurori deri në fund të javës së ardhshme, unë personalisht kam me i marrë ato raporte dhe kam me i dërguar në prokurori...

Kreshnik Radoniqi: Kryeshef, deri të hënën më dhënë urdhër dikush me i ba procesverbalet e mbledhjes së Komitetit dhe me ia dorëzuar procesverbalin të gjithë anëtareve të KQZ-së dhe, do të veprojmë më tutje...E imja është me e zbatuar një procedurë, dhe unë jam duke u munduar me zbatuar një procedurë, dua ta shoh se çka është diskutu prej komitetit, çka janë të gjeturat e komitetit se vetëm prej raportit të auditimit

ne nuk mundemi me dhënë një vlerësim; nuk jemi të fushës së prokurimit ,nëse doni me zbatuar procedurën kemi me zbatuar deri në fund; nuk mundemi veç shko aty dhe dërgoje raportin në prokurori; dhe unë aty të nënshkruaj blanko dhe le të shkojë në prokurori; Jo, duhet me pa një procedurë se si ka rrjedhë dhe mandej kemi me e dërguar në prokurori nëse është e nevojshme, por me ngritë këtë çështje qe katër mbledhje pa u zbatuar krejt procedurat si po e kërkoj unë me u zbatuar procedurat, po më duket e paarsyeshme; E kemi filluar qe gjysmë orë mbledhjen dhe ende s'kemi mundur me kalue në pikën e radhës së aktiviteteve...Unë ju kisha lutë me e ndërpre këtë diskutim se, nuk jemi duke fshehur asgjë dhe nuk jemi duke hezituar për asgjë...

Sami Kurteshi: Nuk ju akuzoj juve personalisht, pra, unë po ju them se në këtë institucion ka veprime që janë të fshehta dhe përpiqen me u m'shefë; e pra, ne jemi të interesuar asnjë veprim publik i institucionit publik mos me u mbet i fshehtë ,asnjë fare ,ne kemi ngritë çështje të auditorit ,çështje të përdorimit të mjeteve ,kanë humb janë heshtë ,nuk jeni ju fajtori ,ne e dimë kush është fajtori ,ne po kërkojmë çështjet publike me u trajtuar publikisht ,zyrtarisht me e marrë rrugën e vet

Kreshnik Radoniqi: Unë, dua vetëm një procedurë me u respektuar nëse ka mundësi...

2. Aktivitetet e Sekretariatit

Burim Ahmetaj: Me datën 8 shtator, keni pranuar raportin e aktiviteteve të Sekretariatit, janë të listuara disa prej aktiviteteve, mirëpo në pika të shkurta do të mundohem të bëj një prezantim të atyre. Aktualisht, periudha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit ka përfunduar me datën 7 shtator dhe përgjatë kësaj periudhe janë parashtruar rreth 8000 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit. Prej tyre, rreth 6000 kërkesa kanë qenë për ndërrimin e qendrës së votimit përmes platformës online të cilën e ka KQZ në ueb faqe, ndërsa rreth 2000 kërkesa janë parashtruar në zyrat e KKZ-së përmes formularëve të aplikimit për ndërrimin e qendrave të votimit. Pra, me datën 7 shtator ka përfunduar edhe periudha e kundërshtimit dhe sfidimit të listës përfundimtarë të votuesve. Sipas informacioneve që i kemi nga zyrtarët komunalë zgjedhorë nëpër secilën komunë deri më tani nuk është raportuar asnjë rast që ka të bëjë me kundërshtimin dhe sfidimin e listës së votuesve. Po ashtu, në raport janë të detajuara edhe numri i ankesave që janë të parashtruara nga qytetarët për mos përfshirjen në listën e votuesve jashtë vendit ku prej më shumë se 600 ankesave në PZAP prej tyre 22 raste ,PZAP ka urdhëruar KQZ-në që ti përfshijë në listën e votuesve jashtë vendit

Sekretariati, është në përgatitjen për certifikim të listës përfundimtare të votuesve ,ku ka kërkuar me datën 9 shtator edhe ekstraktin e tretë të listës përfundimtare të votuesve për nga regjistri qendror civil. Pra, pas pranimit të këtij ekstrakti pra sekretariati duhet të bëjë aplikimin e të gjitha ndryshimeve përfundimtare në listën e votuesve. Kështu, me datat 11 dhe 12 shtator do të fillohet edhe procesi i ndarjeve të votueseve sipas vendotimeve pra ndarja e votuesve do të behet sipas renditjes alfabetike të mbiemrave dhe të emrave të votuesve dhe javën e ardhshme do të sillet në KQZ-lista përfundimtare e votuesve për miratim e cila, do të shërbej në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021.

Një ndër proceset më të rëndësishme që aktualisht jemi duke u marr është edhe procesi i identifikimit të gjithë stafit të angazhuar në zgjedhjet përfshi edhe stafin permanent. Sa i përket imunizimit të vaksinimit të trupave zgjedhore ne raport keni edhe raportin e datës 7 shtator ku më shumë se 70% e gjithë stafit e angazhuar në zgjedhje janë të vaksinuar me dozën e pare dhe më dozën e dytë. Janë diku rreth 36% të vaksinuar ndërsa, sipas raportit gjithmonë të datës 7 shtator të pa vaksinuar i kemi edhe 27% të stafit të angazhuar në zgjedhje që nënkupton që janë edhe një pjese e vogël i stafit nga stafi permanent që punojnë në KQZ-ë. Mirëpo, sipas deklarimeve të tyre të gjithë janë në proces të terminëve për tu vaksinuar dhe kjo nënkupton që deri më datën 13 shtator besojmë që do të kemi në mase të madhe të gjithë stafin e angazhuar në zgjedhje të vaksinuar.

Pra, pas datës 13 shtator sipas vendimit të Qeverise së republikës së Kosovës i gjithë stafi duhet të posedoje dëshmi të vaksinimit ose testin PCR-ë 48h në mënyre që të i lejohet qaseje për të punuar ne institucione publike në këtë raste në komisionin qendror të zgjedhjeve. Mirëpo komisionin qendror të zgjedhjeve e pret edhe një aktivitet i cili është në ditët ne vijim i cili është procesi i nominimit të anëtareve të këshillave të votimit pra dhe emërimi i tyre nga KQZ-ë.

Gjithmonë sipas vendimit të qeveris së Republikës së Kosovës, pas datës 13 shtatore personave të pa vaksinuar nuk ju lejohet të janë në konvente të punës. Lidhur më këtë e rekomandojmë KQZ-vë që ti drejtohet ministrisë së shëndetësisë për te i jep prioritet dhe mundësi e vaksinimit të gjithë personave të cilët nominohen nga subjektet politike pra është fjalë për anëtarët e këshillave të vendotimeve dhe trupave të tjerë zgjedhore që do të angazhohen në ditën e zgjedhjeve ne mënyre që të arrihet kompletimi i procesit të vaksinimit pra të gjithë stafit që do të angazhohet në procesin e zgjedhjeve. Të gjithë ata të cilët dëshmojnë me certifikate të vaksinës do mund të ndjekin edhe procesin e trajnimit dhe respektivisht do mund të punojnë edhe në ditën e zgjedhjeve. Mirëpo kësaj liste duhet të i shtohet edhe lista e stafit jo permanent që aktualisht që e kemi nëse mbet dikush i pa vaksinuar të i jepet prioritet dhe mundësi pra

që është i angazhuar nga KQZ-ë si dhe konsiderojmë që të gjithë vëzhguesit vendor duhet të jene në këtë listë me prioritet për tu vaksinuar.

Ndërsa, tha z. Ahmetaj, në raport e keni po ashtu edhe disa aktivitete të tjera që jemi duke e finalizuar edhe QNR-ë dhe bartjen e të gjithë materialit të cilët i përkasin QNR-së dhe ajo çka është më rendësi është duke u përgatitur plani për monitorimi i gjithë proceseve që zhvillohen në QNR-ë për tu monitoruar nga kamerat vëzhguese të cilat KQZ-ë i ka huazuar nga KQZ-vë të republikës së Shqipërisë pra të gjitha pamjet e këtyre imazheve do të ruhen në serverin e KQZ-së dhe jemi në fazën e përgatitjes finale në mënyre që te monitorohen të gjitha aktivitetet deri në certifikimin e rezultateve në QNR-së. Pra në pika të shkurta këto janë disa prej aktiviteteve nëse keni pyetje mund të ju japë përgjigje. Faleminderit.

Ilir Gashi: Faleminderit, po ndalem kryesisht të ky shqyrtimi i madhe që tha edhe krye shefi sa i përket trupave zgjedhore pa të cilët edhe nuk mund të mbahet procesi zgjedhore dhe pas datës 13 duhet nuk mund të jete askush ne institucione publike dhe private. Në qoftë se nuk është i vaksinuar si pasojë, neve na duhet urgjent me pas një kontakt të domosdoshëm më ministrin e shëndetësisë përmes një memorandumit të shpejt apo, edhe kështu marrëveshje sepse zgjedhjet nuk janë vetëm obligime i KQZ-së por janë obligime i të gjitha institucioneve të Kosovës, është organizimi më i madhe që behet brenda një shteti. Kështu që nëse janë mbi 20 mije njerëz të cilët janë të angazhuar direkt dhe indirekt në këtë proces atëherë natyrisht na duhet ndihma e secilit institucione për ta bërë procesin zgjedhore më të mirë dhe për ti dhënë mundësi situatës së krijuar sa i përket pandemisë...

Paraprakisht, ndoshta një sensibilizim sa i përket subjekteve politike të cilët trupat zgjedhore që dërgohet nga ta për ti dërguar siç janë këshillat e vendotimeve, më vonë edhe vëzhguesit duhet që ne ti kemi listat e tyre përmes një komunikimi me ministrin e shëndetësisë që të ju krijohet mundësia me pas terminë të shpejta dhe mendoj se nëse kjo bëhet shpejt, atëherë deri në ditën e zgjedhjeve ata mund të kenë vaksinimin edhe më dozën e dytë... Kryesues, këtë temë dhe mendoj që ndoshta jo nesër po edhe sot, duhet me pasur këtë përpjeke me ra në kontakt më ministrinë e shëndetësisë...

Ibrahim Selmanaj: E ndaj të njëjtin mendim më Z. Gashi. Kemi të bëjmë më një trup zgjedhore të cilët sillet numri rreth 30 mije persona kjo ka të bëjë me të gjitha subjektet politike dhe kemi njëfarë forme njerëz me provojë në organizimin e zgjedhjeve dhe pa këta njerëz, nuk mundemi me pasur një proces të besueshëm të zgjedhjeve... Po, kërkojë që të kemi një marrëveshje më ministrinë e shëndetësisë dhe kjo të ndahet në nivel komunal, të këtë një marrëveshje në mese subjekteve politike se të gjitha subjektet përfaqësohen nga njerëzit, dhe një farë forme, secili i ka prioritetet e veta dhe kjo gjendje alarmante që

është tani, ndoshta po e bartim ne tek një gjeneratë më e re...Por në fakt, janë njerëzit që kanë me i organizuar zgjedhjet dhe ne jemi përgjegjës...

Alim Rama: Unë kam një çështje tjetër që lidhet me përgatitjet e QNR-së. Në gusht, ka qene afati i fundit më marr përgjigje nga sistemi gjyqësor, a është marr ndonjë përgjigje... (është e pa kuptueshme dhe dëgjimi i dobët)

Sami Kurteshi: Faleminderit kryesues, ishte çështja te listat e votuesve...! Në një vend, thatë “lista përfundimtare”, unë vetëm dua me shtruar pyetjen qysh këto janë listat përfundimtare që kanë të bëjnë më caktimin e vendvotimeve, po sigurisht d.m.th, një liste me ato pastrimet e personave të vdekur, personave që kanë heq dorë nga shtetësia, personave që fitojnë drejtën e zgjedhjes në ditën e zgjedhjeve, në kontekst: do të merret 1, 2 apo 3 dite më herët nga Agjencinë për regjistrimin Civil, apo...?

Kreshnik Radoniqi: Sa i përket vaksinimit, ideja është së të gjithë anëtarët e nominuar prej partive politike duhet me qenë të vaksinuar apo të paktën në ditën që kanë me punuar, duhet të dorëzojnë testin PCR-ë. Kjo ndoshta edhe përmes juve që vini prej subjekteve politike me i dërguar ndonjë mesazh se, tani nëse dikush vaksinohet tani lypet 1 muaj të paktën për vaksinën e dytë, por ndoshta nuk kemi kohë deri më 17 tetor se tani edhe 2 jave pas vaksinës, pra është një kohe kritike... Unë, i kisha ftuar partitë politikë që do ti nominojnë personat të cilët janë te vaksinuar apo, të njëjtit duhet me qenë në vend të punës me testin PCR-ë.

Sa i përket asaj çështjes që e shtroi z. Rama, së bashku me krye shefin jemi takuar edhe me prokurorin, edhe më kryesuesin e këshillit gjyqësor dhe, jemi marr vesh...Me sa kam kuptuar dje, është berë lista përfundimtarë e të gjithë atyre listave të votimit që duhet me u liruar dhe, unë po shpresoj që në javën tjetër përfundon kjo çështje....

Burim Ahmetaj: Sa i përket pyetjes për komunikimet më agjencinë e regjistrimit civile të Kosovës ne vazhdimisht kemi pasur kontakt dhe komunikimë të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të ekstraktit të parë dhe ekstraktit të dytë dhe tani jemi para marrjes së ekstraktit të tret po ashtu na ka shërbyer edhe gjatë procesit të identifikimit të personave gjatë aplikimit të votuesve jashtë vendit si dhe na shërbyer komunikimi gjate periudhës së certifikimit të kandidateve kështu që jemi në kontakt të vazhdueshëm ku të gjitha këto i kemi inkorporuar dhe besojmë që javën e ardhshme kur të sjellët para KQZ-vë për tu miratuar do të jenë te inkorporuar të gjitha këto ndryshime dhe do të kemi edhe një muaj ditë kohë për ndonjë përmasime eventual që do të na dal gjatë rrugës dhe sigurisht që ajo që kemi diskutuar edhe neper punëtori edhe para ditës së zgjedhjeve do të kemi edhe versionin e fundit për çdo ndryshime eventual që

mund të ndodh prej miratimit të listës përfundimtare të votuesve deri në dy dite para ditës së zgjedhjeve dhe jemi në komunikim të vazhdueshëm.... Faleminderit

Ilir Gashi: Mendoj që neve të gjithëve sa i përket kërkesës për vaksinonim të trupave zgjedhore mendoj që një qarkore, është mirë prej zyrës që ka kontakte direkte me persona kontaktues së subjekteve politike me u ba si kërkesë dhe pastaj, krijohet edhe vendim...Po ashtu, është mirë një informim i saktë sa u përket kandidatëve për asamble komunale të cilët kanë aplikuar për letërnjoftim por, si pasoje nuk kanë mundur më marr letërnjoftimet për shkaqe që po dihen: të sigurohen që janë në listën përfundimtare të votuesve në komunat ku ata e kanë ndërruar vendvotimin në mënyre që të mos bimë në një situatë të pa këndshme në momente të fundit....sepse, ai është kandidatë i certifikuar dhe në fund nuk është në listën votuese të komunës...

Arianit Elshani: Kisha me theksuar edhe një here këtë kërkesën e fundit të cilën e vlerësoj shumë më vend lidhur me gjithë kandidatet për asamble komunale, për kandidatet për kryetare komunash që para se të certifikohet edhe lista përfundimtare e votuesve fillimisht duheni pra para se të miratohet është mirë që të bëni një verifikime edhe një here, e di që këtë procedurë të verifikimit e keni bërë personat kanë pru ata aplikacionet për letërnjoftim mirëpo të shikoni edhe një here në qofte se a janë në rregull data bazën e listës votuese edhe të kandidatëve për asamble komunale që mos të kemi pastaj ndonjë ankese ndonjë tërheqje....

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.

Yll Buleshkaj : Faleminderit, të nderuar keni pranuar pak më herët (dje në të vërtetë) rekomandimin për akreditim të një numrit të organizatave dhe një numri të vëzhguesve të tyre. Paraprakisht, kisha pasur dëshirë të ju informojë për ata që nuk kanë mundur dje të jenë prezent se, është bërë tërheqja e shortit për radhitje subjektet politike në fletëvotime d.m.th, 89 subjekteve politike të certifikuar u janë ndarë numrat ashtu siç, i kanë zgjedhur vetë...Tani, jemi në fazën finale të përpunimit të listave dhe dorëzimit të tyre te shërbimi i cili do i draftojë fletëvotimet tjerat pastaj, të njëjtat do të aprovohen nga KQZ-ja...Sa për informatë, ndoshta kemi marrë disa lajme për ndërrim jete të disa kandidatëve të cilët, me gjasë duhet të hiqen nga lista e kandidatëve....Tjetra: mendojmë duhet për tu dërguar subjekteve politike një qarkore ku do tu kërkonim apo inkurajonim qofshin Tani, të kthehemi te rekomandimi jonë: para jush e keni rekomandimin për akreditim të 3 organizativë dhe 1 partie politike për vëzhgues. Siç, edhe e do rendi

zyra e ka shqyrtuar gjithë aplikacionin një nga një dhe ka vlerësuar se këto organizata i plotësojnë të gjitha kushtet juridike dhe formale për tu akredituar si organizata për vëzhgime të zgjedhjeve si dhe për akreditim të vëzhguesve të tyre. E para, ka dorëzuar më 7 shtatore kërkesën për akreditimin e 13 vëzhguesve të parë afatgjatë, të gjithë këta i kanë përmbajtur kërkesave ligjore dhe rekomandojmë KQZ-së që ti akreditojë...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për akreditimin e vëzhguesve EU EOM me 13 vëzhgues. Më 10 vota për miratohet kërkesa e EU EOM për akreditimin e 10 vëzhguesve afatgjatë për procesin zgjedhore 17 tetorit 2021.

Yll Buleshkaj: Rekomandimi i dytë është për organizatën që vjen nga Maqedonia për akreditim të 7 vëzhguesve.

Kreshnik Radoniqi: Nëse s'ka dikush diçka më deklaruar kush është për akreditimin e kësaj organizate. Më 10 vota për, akreditohen 7 vota vëzhgues për vëzhgimin e aktiviteteve zgjedhore .

Yll Buleshkaj: Organizate ndërkombëtare në të vërtetë, është rrjetë i organizatave me qendër në Podgoricë i cila, ka vëzhgues nga 18 vende dhe nga 23 organizata të specializuara për vëzhgime të zgjedhjeve ka aplikuar për akreditimin e 6 vëzhguesve afatgjatë në Kosovë. Të gjithë këta, i kanë plotësuar kushtat për vëzhgues dhe rekomandojmë që miratohet rekomandimi ynë...

Kreshnik Radoniqi: Nëse s'ka dikush diçka, kush është për ? Me 10 vota për, akreditohet OJQ-ë ndërkombëtarë me 6 vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale.

Yll Buleshkaj: Subjekti politike "Iniciativa qytetare për Mogillën", është një subjekte politik i certifikuar që ka dorëzuar kërkesën për akreditim të 3 vëzhguesve afatgjatë të tyre dhe të njëjtit, i kanë përmbajtur të gjitha kërkesat ligjore dhe rrjedhimisht rekomandojmë akreditimin e tyre.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse s'ka dikush diçka, kush është për ? Me 10 vota për, miratohet rekomandimi i zyrës për akreditimin e 3 vëzhguesve afatgjatë për zgjedhjet lokale 2021.

Yll Buleshkaj: Nëse me lejohet, ju informoj se kemi pasur kontakte edhe me divizionin e shqyrtimit votues për lista votuese dhe, ata do të sigurojnë se kush do që është certifikuar, do të jetë edhe në listën përfundimtare sepse, paraprakisht ne kemi pranuar nga ARC informatën që kërkesa e tyre për të ndërruar komunën, është aprovuar d.m.th, para se të bëjmë rekomandimin për certifikime jemi siguruar që ARC-ë i ka aprovuar kërkesat për ndërrim të komunës, e këto, rrjedhimisht mund të reflektojnë në listën përfundimtare. Nëse ka ndonjë problem, do të marrim veprime një nga një...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka, a mundemi me vazhdua me pikën e radhës bordeve të këshillave të KQZ-së. Para së me vazhduar, mbledhjen e fillova më një ngushëllime por më doli prej mendjes fakti se dje, më të vërtet ka qenë një ditë e zezë: ngushëllime edhe familjes prej Gjakovës që kanë pësuar humbjen e dy fëmijëve në rastin e tragjedisë së djegies së shtëpisë së tyre...?

4. **Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit të anëtarit të KQZ-së në komunën e Glllogocit:**

Arianit Elshani: Faleminderit, i bashkëngjitëm ngushëllimeve. Në takimin e fundit, KOZ ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të komisionit komunal të zgjedhjeve në komunën e Drenasit dhe, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë meqë ka plotësuar të gjitha kriteret juridike, e kemi aprovuar dhe rekomanduar që të miratohet edhe këtu në KQZ. Behet fjalë për zëvendësimin e z. Vehbi Morina me z. Albert Ramaj nga PDK.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka, kush është për? Me 10 vota për, Albert Ramaj emërohet anëtar i komisionit komunal të zgjedhjeve në komunën e Drenasit nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin Vehbi Morina.

2. **Raportit njoftues nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë:**

Arianti Elshani : Këshilli për Operacione Zgjedhore, ka rekomanduar që të behet verifikimi i një mostre të disa komunave sepse, kemi konsideruar se është një numër më i madh i të aplikuarve në raport me numrin e popullsisë krahas komunave të tjera... Bëhet fjalë për Dragashin, Suharekën, Junikun dhe Mamushën dhe se nga ky proces i verifikimit të aplikacioneve përmes thirrjeve telefonike pra, mostrës prej 2% për këto komuna është konstatuar në rreth e 54%. Edhe pse është numër më i madh, sekretariati nuk e ka përimituar këtë raport njoftues ngase se e kanë bërë vlerësimin dhe verifikimin edhe gjatë ditës së djeshme. Pra, bëhet fjalë për komunën e Dragashit, Suharekës edhe Junikut të cilat, kemi konsideruar se në mënyrë të kënaqshme është arritur në mbi 60% të konfirmohen ato aplikacione prej mostrës së 2%.

Është shqetësuese sigurisht, numri i atyre që nuk e hapin telefonin dhe, jo për ata që e konfirmojnë se nuk janë persona që kanë aplikuar por, kemi rekomanduar që të vazhdohet edhe më tutje më thirrje telefonike për këto komuna, ndërkohë për komunën e Mamushes për shkak të numrit jashtëzakonisht të

madh të aplikuesve të cilët konfirmojnë se nuk janë persona që kanë aplikuar për regjistrim apo nuk e hapin telefonin, kemi rekomanduar që numri në total prej 245 personave të cilët kanë aplikuar nga kjo komune, të kontaktohet patjetër secili deri të hënën dhe pastaj, të vijmë me një rekomandim për KQZ-në qoftë se konstatohet për largim nga lista e votuesve jashtë vendit... Pra, ky është rekomandimi vetëm si njoftim, është rekomandimi që kemi dhënë si KOZ për sekretariatit për komunën e Mamushës dhe për ato dy komuna tjera që shpresojmë se ditët në vijim do të përmirësohet rezultati i atyre që konfirmojnë se kanë aplikuar personalisht...

Kreshnik Radoniqi: Urdhëroni z. Kurteshi

Sami Kurteshi : Unë, kam dy pyetje” E para, a ka ndonjë ide apo informatë sepse numri i aplikuesve nga jashtë në këto komuna është shumë më i madh se në komunat tjera, nuk po them që duhet dikush me e ditë patjetër mirëpo, është shumë i madh prandaj, edhe dyshimi ka ngjarë edhe është e arsyeshme me telefonue, e dyta, çështja është e Mamushës...! Unë, e dëgjova arsyetimin se ata, kryesisht nuk janë lajmëruar në thirrjet e bëra. E kam një pyetje: ata persona që lajmërohen që thërrasin në telefon, personat që janë lajmëruar nga komuna e Mamushës, a e flasin gjuhën turke...?

Unë, mund ta marr me mend që një numër i madh i tyre jetojnë në Turqi. Ata, janë qytetarë që kanë të drejtë vote por që nuk e dinë shqipen fare. A keni ndërmarrë një veprim që këtyre personave me ua gjet një njeri që komunikon me ta turqisht ?

Ibrahim Selmanaj: Edhe unë e kisha bërë një pyetje: Juniku dhe Deçani janë komunitete të afërta. Në Deçan (nuk dëgjohet), ndërsa në Junik janë 1051. Fakti që me 2 % të verifikimit (22 nuk janë përgjigjur), jep një indikacion të dyshimit . Propozoj që të verifikohen të gjithë emrat (nuk dëgjohet). Juniku tradicionalisht, ka 2700 vota në total: si votues brenda vendit. Janë 1051 aplikacione, propozoj që të bëhet verifikimi i tyre...

Arianit Elshani: Tani u konfirmua nga Sekretariati se për komunën e Mamushës, telefonatat janë bërë në gjuhën turke, janë thirre për t’i konfirmuar ato aplikacione, ndërsa këto komuna, në përgjithësi kanë një shifër të kënaqshme të atyre që kanë konfirmuar, mirëpo do të vazhdohet me ata që nuk janë përgjigjur fare...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së Fletëvotimit:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar për dizajnin e vulës së fletëvotimeve, dizajn ky që kohëve të fundit e kemi ndryshuar pothuajse në çdo palë zgjedhje për shkak të disa iniciativave të mira që kemi marruar si

KQZ. Pra që nga zgjedhjet e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, zgjedhje të jashtëzakonshme pastaj në zgjedhje nacionale lidhur me vendosjen e një kodi pra, një barkodi të secilit fletëvotim që të mos lejohet ajo që ka ndodhur nëpër zgjedhje parlamentare dhe ato lokale ku fletëvotimet e një vendvotimi janë përdorur në një vendvotim tjetër nga ata që kanë tentuar të manipulojnë procesin zgjedhor. Për ti ikur kësaj tendencës për tu mundësuar atyre manipulimin e zgjedhjeve, KOZ-i në zgjedhjet e fundit ka marrë vendim që ti vendosim kod secilit fletëvotim ku e dimë saktë se një fletëvotim i takon një vendvotimi të caktuar dhe, meqenëse kemi bërë këtë hap pozitiv si KQZ tash na duhet ta ndryshojmë edhe vulën e cila vendoset në secilën fletëvotim.

Këtë vulë, tha z. Elshani, e kemi bërë të përgjithshme, ky është dizajni i vulës L-2021 dhe për shkak të kursimit edhe të parasë publike dhe meqë nuk është e nevojshme për shkak të atij kodi që kemi vendosë në fletëvotime...Deri vonë, kjo vulë ka qenë me dizajnin ku është vendosur kodi i vendvotimit dhe kësaj here, nuk kemi nevojë për atë, kemi nevojë për një vulë të përgjithshme meqë kemi personalizuar secilin fletëvotim. KOZ-i, rekomandon që të aprovet dizajni...

Kreshnik Radoniqi : Kush është për miratimin e dizajnit te vulës së fletëvotimeve ?

Me 9 vota për, miratohet dizajni i vulës së fletëvotimeve për zgjedhjet lokale 2021.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të vulës së VPNV-së.

Arianit Elshani: KOZ – i, ka shqyrtuar edhe rekomandim e Sekretariatit për dizajnin e vulës për personat me nevoja të veçanta. Është një dizajn që është përdorur zakonisht në zgjedhje dhe nuk ka ndryshime. Prandaj, rekomandojmë që të aprovet. Është një vulë që do të jetë prezent në secilën KKZ, listat dhe fletëvotimet do të vulosen me këtë vulë, pra do ti dimë fletëvotimet e përdorura për personat me nevoja të veçanta, mirëpo në anën tjetër edhe do të verifikohen. Andaj, rekomandojmë që të aprovet...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush tjetër diçka, e hedh në votim. Kush është për miratimin e këtij dizajni? Me 10 vota për miratohet dizajni i vulës së votimit për personat me nevoja të veçanta.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit te votuesve për vendvotim:

Arianit Elshani: Këshilli për Operacione Zgjedhore ka shqyrtuar po ashtu kërkesën dhe rekomandimin e Sekretariatit për rritjen e numrit të votuesve për një vendvotim. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që secili vendvotim të ketë një përbërje prej 750 personave në listën votuese të atij vendvotimi

me ç 'rast në qoftë se do të implementohet nga KQZ-ja dhe do të kishim 2950 vendvotime që do të rriste edhe kostot mirëpo, në anën tjetër duke marrë parasysh koston dhe pagesat e këshillave të vendvotimeve dhe numrin e vendvotimeve që do të krijoheshin (zakonshëm KQZ ka marrë vendim që këtë numër nga 750 ta rrisë në 950 për një vendvotim), pastaj duke e marrë për bazë edhe faktin që përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje të listës përfundimtare të votuesve sillet nga 40 deri në 47 % , varësisht edhe prej rajoneve prej vendeve; pjesën veriore kemi një pjesëmarrje më të madhe mirëpo aty janë edhe dyshimet e vëzhguesve të huaj mirëpo edhe të shoqërisë civile lidhur me pjesëmarrjen në atë pjesë të Kosovës; mendojmë që edhe në këto rrethana të pandemisë dhe Covidit ky numër prej 950 në secilin vendvotim konsiderojmë që nuk rrezikon shumë shëndetin...Është përdorur ky "950" edhe në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, prandaj rekomandojmë që të miratohet...Kjo, edhe për faktin se do at ulnim edhe numrin e vendvotimeve, ra nga 2959 vendvotime, ky numër do të ullej në 2441 vendvotime...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Alim Rama dhe Burim Ahmetaj kryesisht, nëse rritja e numrit të votuesve në vendvotime nuk ka ndonjë efekt negativ...!

Kreshnik Radoniqi: Atëherë nëse nuk ka dikush diçka, kush është për ? Me 10 vota për, miratohet rritja e votuesve në vendvotim për zgjedhjet lokale 2021: nga 750 votues, në 950 votues në një vendvotim.

5. **Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

Njoftim nga Këshilli për informim publik

Fazli Stollaj: Një njoftim të shkurtër lidhur me punën që e ka bërë Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik: E para, këshilli ka mbajtur dy mbledhje prej herës së fundit kur kemi raportua dhe është shqyrtuar objekti që ka të bëjë me përgatitjen e kontrollit të radiospoteve për plotësimin e fletëvotimit "Si të plotësohet fletëvotimi" dhe "si të votojnë votuesit që janë regjistruar jashtë Kosovës". E dyta, është shqyrtuar teksti dhe dizajni i fletushkës që do të përdoret nga vëzhguesit dhe teksti që do të përdoret për radiospote, d.m.th., në mbledhjen e datës 2 shtator. Po ashtu, kemi shqyrtuar tekstin por, nuk e kemi miratuar atë ditë" teksti i cili tregon se si duhet të votohet jashtë Kosovës. Ndërsa me datën 8 Shtator (nuk dëgjohet...)

Sami Kurteshi : Unë megjithatë po e ngrit këtë çështje: ne, nuk jemi ndonjë përjashtim në botë dhe në Evropë për numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, sillet prej vendit në vend, prej rrethanave, dikund 3% deri 10 %, mund të themi që nganjëherë edhe shtetet shumë të zhvilluara kanë problem Por, unë po fokusohem në Kosovë ! Ne, kemi numër të konsiderueshëm të fletëvotimeve të pavlefshme, ne kemi bërë

edhe një analizë se cilat kanë qenë fletëvotimet e pavlefshme...! Po pyes: a, është bërë ndonjë ndryshim në cilësi apo tekst, thjeshtësimi i tekstit që së paku të shmangen sa më shumë momentet kur njerëzit nuk e dinë, bëjnë gabime, jo ata që e prishin fletëvotimin në mënyrë të vetëdijshme, është veprim politik i tyre ky, kjo quhet votë protestë, por personat që bëjnë gabime për shkak që nuk e kanë kuptuar, ky mundësisht të pakësohet te fletëvotimet e pavlefshme...!

Unë, vetëm po pyes se, a është teksti në rregull dhe ajo çka kemi vërejtur në zgjedhjet e fundit, unë të paktën, e kam vërejtur në qendrën e numërimit është fletëvotimi që është plotësuar në mënyrë të rregullt, dhe te 50, 60, 100 fletëvotime kemi një vijë dikund jashtë atyre katrorëve që janë të domosdoshëm dhe shihet se, është dorë e njëjtë dhe është laps i njëjtë...Bile, edhe që ndryshon nga lapsi me të cilin është bërë votimi... Ai person, e di që ato fletëvotime shpallen të pavlefshme dhe, ky quhet manipulim; Shihet se e ka vënë dikund mbi vijë me të cilën shpallet fletëvotimi i pavlefshëm, ky është manipulimi, shkatërrimi i votës të subjektit të caktuar...

Fazli Stollaj: Ne si këshill, kemi konsideruar që numri më i madh i fletëvotimeve të pavlefshëm ka ardhur kur votuesit votojnë për kandidatin e jo subjektin politik, dhe këtë e kemi vendosur mirë, dhe që kjo theksohet edhe në produktet e informimit si te videospoti; Për këtë arsye kemi konsideruar që kjo thirrja që të votohet subjekti politik dhe kandidati, të potencohet dy herë, e jo vetëm një herë...Konsiderojmë që kemi bërë përpjekje që teksti të jetë sa më i kuptueshëm, sa më i thjeshtë që njerëzit ta kuptojnë por ajo varet si do të realizohet videospoti sepse, është në realizim e sipër...

Në këtë fazë, e kemi miratuar vetëm tekstin por ilustrimet që do të bëhen do ta mundësojnë që kjo të jetë edhe më e kuptueshme...

Ilir Gashi: Edhe në mbledhjen e kaluar e hapëm temën e fletëvotimeve të pavlefshme. Sot veç u tërhoq doracak (nuk dëgjohet), vlefshmërinë dhe jo vlefshmërinë e fletëvotimit në mënyrë që tua bashkojmë trupave zgjedhore dhe ata pastaj, duhet ta kenë të qartë kur një fletëvotim është i pavlefshëm dhe kur identifikohet qartë qëllimi i votuesit dhe, vlerësimi i një fletëvotimi në raport me qëllimin që ka pas votuesi...Andaj, ne duhet me pas shumë kujdes në doracak pastaj, edhe te edukimi i trupave tonë zgjedhorë. Edhe në QNR kemi me pas probleme, prandaj pavarësisht informimit të publikut ne kemi me u përballë me problematika sepse, tash në zgjedhje lokale është më e vështirë sepse kemi të bëjmë me kandidatë e në veçanti, me kandidatë për kryetar të komunave e që, edhe mund të ketë rezultate të ngushta...

Fletëvotimet e pavlefshme mund të qojnë deri te rezultati ndryshe dhe pastaj, kjo mundet me na sjellë shumë probleme. Ne, duhet ta vendosim saktë përshkrimin e qartë të një fletëvotimi kur vërtetë është i pavlefshëm, dhe kur konsiderohet i vlefshëm...

Kreshnik Radoniqi: Në këtë aspekt, a duhet me pas ndonjë koordinim në mes të Këshillit për Operacione Zgjedhore dhe Informimit Publik?

Ilir Gashi: Kryesues, informimi është në rregull por doracaku pastaj, po është edhe përballja direkte me problematikën në vendvotim, në QNR...